

KOMENT



**VRASJA E DYTË
E REFORMËS
'AMERIKANE' NË
DREJTËSI**
ANDI BUSHATI

Faqe 2

INVESTIGIMI



**HIJENA
SHPORRUNI, UJIN
DO E MBROJMË ME
GJOKSET TONA**
DR. SELMAN MËZIU

Faqe 4

REÇENSA



**E NJË GJAKU ME
ËNDRRËN.....**
PËR ROMANIN AUTOBIOGRAFIK
"KROM DHE LULEDELE" TË ELSA
SKËNDERI RAKIPLLARIT
AGRON TUFA

Faqe 6

Kompanitë konçensionare të nxjerrjes dhe përpunimit të kromit rrezikojnë falimentimin

MINIERAT E KROMIT NË KOLAPS



EDMOND ISAKU
ANËTAR I KËSHILLIT
KOMBËTAR TË PD-SË

Kompanitë konçensionare të nxjerrjes dhe përpunimit të kromit rrezikojnë falimentimin. Kjo situatë i ka shqetësuar biznesmenët e subjekteve të prodhimit të kromit Bulqizë, të cilët parashikojnë përkeqësimin e situatës financiare të kompanive që ata drejtojnë. Muajt e fundit çmimi i mineralit të kromit si dhe kërkesa në treg është përgjysmuar si dhe kërkesa në treg ka pësuar një rënie të theksuar, duke qenë prej një viti shumë e ulët. Një situatë e tillë e konjunkturës së kromit në treg është prej një viti dhe vazhdon të përkeqësohet. Çmimi prej një viti qëndron rreth 150 \$ deri 200 \$ për ton me 42 % Cr2O3. Aktualisht këto subjekte minerare janë në kolaps pasi nuk mbulojnë koston e prodhimit. Ndaj duke u ndodhur në këto kushte, subjektet po hasin vështirësi të mëdha në pagesën e faturave, pagave të punonjësve dhe të detyrimeve tatimore, si dhe detyrimet portuale.

Faqe 3

Për të dalë nga kolapsi, subjektet e prodhimit të kromit Bulqizë kërkojnë që:

- Të hiqet ose të ulet në 2 % renta minerare.
- Të ulen shpenzimet portuale.
- Të mos vihen sanksione tatim-fitimi.

Zgjidhja duhet të vijë në një qëndrim për biznesin minerar në shkallë kombëtare, pasi këto probleme nuk janë vetëm për Bulqizën por për mbarë vendin

Elita e artistëve të skenës, ekranit e muzikës në promovimin e librit të 15-të të publicistit e shkrimtarit Halil Rama

Skënder Cala - "Mjeshtër i Madh", në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare



SAKIIP CAMI

Faqe 7

AKTUALITET

Faqe 5

Fshati Zogjaj pa mjek

Ku është "shëndetësia falas" e qeverisë së "Rilindjes? Fshatrat vuajnë braktisjen totale



PROMOVIMI

Faqe 8


U promovua libri me poezi "Vargonjte e fatit" i autores Bulqizake Barie Çupi



TREGIM

Faqe 10

Ku do të shkosh Ela



REFERATI

Faqe 9

"LANÇ në Dibër", vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare



Zgjedhja e dy anëtarëve të Kushtetueses, PD: Puç kundër drejtësisë me porosi të Ramës

Për Partinë Demokratike, zgjedhja e dy anëtarëve të reja të Gjykatës Kushtetuese është konsideruar si një puç kushtetues kundër drejtësisë së pavarur.

Sekretari i përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi në një deklaratë nga selia blu tha se PD dënon projektin e rilindjes për të kapur Gjykatën Kushtetuese.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike Gazment Bardhi e cilëson si një puç kushtetues votimin e dy anëtarëve të rinj të këtij institucioni nga mazhoranca aktuale. Selia blu akuzon kryeministrin Edi Rama se po tenton që të kapë Kushtetuesen. Sipas Bardhit i gjithë procesi i kryer nga kryetari i KED, Ardian Dvorani, me porosi të Edi Ramës, ka sjellë një 'produkt antikushtetues, që eliminoi garën dhe çoi në votim fiktiv nga Kuvendi'.

"Me porosi të Ramës u vu në jetë një puç kushtetues kundër drejtësisë së pavarur nga politika.



PD mbështet një gjykatë kushtetuese funksionale dhe të pavarur, por kurrësi kjo që ndodhi me votimin nga pseudomazhoranca ak-

tuale. PD dënon projektin e Ramës për kapjen e Gjykatës Kushtetuese. Rama përmes KED ka paracaktuar anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese", tha

Bardhi.. Ai tha se "Afati 30 ditor për Presidentin nuk ekziston në Kushtetutë. Është alibi e ngritur nga Rama, me pasojë në funksionimin normal të Gjykatës Kushtetuese".

Përsa i përket zgjedhjes së anëtarëve të rinj, sipas radhës, një duhet ta bëjë presidenti, një kuvendi dhe një Gjykata e Lartë, por në kushtet aktuale Gjykata e Lartë nuk është ngritur dhe nuk jemi në kushte normale.

Por për PD-në, këtu nuk kemi të bëjmë me situatë të jashtëzakonshme edhe pse ky institucion ka dy vite që nuk funksionon. "Nuk ka asnjë situatë të jashtëzakonshme që radha e përzgjedhjes që ka përcaktuar Kushtetuta të mos respektohet. Mungon vetëm Gjykata e Lartë, që është një rrethanë e pavarur nga vullneti i Kuvendit dhe i Presidentit. Prandaj edhe radha që ka caktuar Kushtetuta, për Presidentin dhe Kuvendin, është e detyrueshme të zbatohet" thotë Bardhi.

KOMENT



NGA ANDI BUSHATI

Pas emërimit të Arta Markut si kryeprokurore e përkohshme (që po qëndron në detyrë prej dy vjetësh), Rilindja ka kryer aktin e dytë të madh të shkatërrimit të Reformës në Drejtësi, zgjedhjen në mënyrë të paligjshme të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Në vijim të atij që prej ditësh është përshkruar si një konflikt procedurash mes Kuvendit të Shqipërisë dhe presidencës, fshihet në fakt një lojë e qartë ekuilibrit politik.

Shumica parlamentare kërkonte të shpinte atje dy emrat e saj, të dala nga lista e hartuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili vepron nën influencën e ndjeshme të një drejtuesi si Ardian Dvorani dhe kryeprokurores së përkohshme, Marku.

Pavarësisht nga piruetat që janë bërë në KED, ku njëra nga kandida-

Vrasja e dytë e reformës 'amerikane' në drejtësi

tet (tashmë e shpallur fituese nga kuvendi) nuk plotësonte parametrat as për gjyqtare e shkallës së parë, aty gjithësesi u hartua një listë.

Por në këtë listë gjendej edhe një 'armike e partisë', juristja Marsida Xhaferllari.

Pikërisht në emër të saj u zhvillua beteja.

Kjo zonjë, që bashkëjeton me sa duket me ish deputetin Enkeled Alibeaj, që ka punuar si kryeinspektore e këshillit të Lartë të drejtësisë nën presidencën Nishani dhe Meta, i plotësonte të gjitha parametrat për tu trajtuar si e padëshiruar.

Jo vetëm Dvorani dhe Marku ia ulën asaj pikët në maksimum, jo vetëm që vettingu e hetoi për dy vite dhe në fund nuk mori vendim për të, por u shkua dhe më tej, u prish gjithë arkitektura e procedurës së përzgjedhjes së një gjykatësi kushtetues, vetëm e vetëm për të shkuar tek emrat që i duheshin Rilindjes.

Ashtu siç kuptohet lehtësisht nga qëndrimet e mbajtura nga socialistët në kuvend, ky puç institucional u organizua vetëm që të përjashtohet Meta nga mundësia hipotetike e përzgjedhjes së Xhaferllarit.

Në këtë procedurë fillimisht u shkel kushtetuta. Sepse neni 179 (2) i saj e

përcakton qartë se zgjedhja e anëtarëve duhet bërë me radhë për të ruajtur parimin e ekuilibrit të pushteteve.

Sipas këtij rendi të përcaktuar në mënyrë taksative, as Ilir Meta nuk mund të përzgjidhte dy kandidatë në të njëjtën kohë, dhe as parlamenti dy të tjerë ashtu sikurse bëri sot.

Organizata e Rilindjes zgjodhi të veprojë pikërisht kështu, pra edhe për ti hequr kreut të shtetit të drejtën e dekretimit të një anëtar të ri edhe për ti dhënë vetes një kompetencë që nuk i takon.

Por, për të mbërritur deri këtu skema e manipulimit që më e gjatë. Ajo ishte e rakorduar plotësisht me kryetarin e 'pavarur' të KED, Ardian Dvorani, i cili i mbajti listat e hartuara nga institucioni i tij, të fshehura në sirtar, pikërisht për të krijuar këtë anomalë që i mohonte presidentit të drejtën për të zgjedhur lirisht.

Nga gjithë kjo histori banale kapjesh të shtetit rrjedhin disa përfundime të thjeshta.

Në fakt e keqja më e vogël është dërgimi i njerëzve të rilindjes në majat më të larta të drejtësisë.

Pasojat afatgjata janë shumë më të rënda.

Ato kanë të bëjnë me përdhosjen në mënyrë selektive të Kushtetutës

apo procedurave në varësi të emrave të veçantë.

Ato kanë të bëjnë me shndërrimin në karagjozllëk të një procesi kaq të rëndësishëm, i cili degradon në një lojë kukamshefti fshehesh të postës në sirtarë.

Ato dëshmojnë një mospërfillje cinike ndaj presionit ndërkombëtar, për ta ngritur shpejt kushtetuesen, sepse po e mbajnë atë peng përmes sherreve artificiale me Metën.

Ato tregojnë se Rilindasit jo vetëm nuk i besojnë procesit të cilin e kanë votuar vetë, por nuk ia dalin dot atij mbanë pa e manipuluar.

Natyrisht, për të siguruar pandëshkueshmërinë për krimet më makabre që kanë bërë, ata nuk kanë rrugë tjetër veçse ta kapin krejtësisht drejtësinë.

Dhe këtu po bëjnë krimin më të madh.

Jo se po përpiqen të shpëtojnë veten, por sepse me njerëzit që po emërojnë dhe procedurat që po shkallmojnë, po rilindin mostrën e një drejtësie politike.

Të një mashtrimi, që, ndonëse e duartrokasin si reformë amerikane, nesër do ta përdorin po njësoj edhe ata që do të vijnë pas tyre në pushtet.

/Lapsi.al

MINIERAT E KROMIT NË KOLAPS

Për të dalë nga kolapsi, subjektet e prodhimit të kromit Bulqizë kërkojnë që:

- Të hiqet ose të ulët në 2 % renta minerare.
- Të ulen shpenzimet portuale.
- Të mos vihen sanksione tatim-fitimi

Zgjidhja duhet të vijë në një qëndrim për biznesin minerar në shkallë kombëtare, pasi këto probleme nuk janë vetëm për Bulqizën por për mbarë vendin



EDMOND ISAKU

Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së

Kompanitë konçensionare të nxjerrjes dhe përpunimit të kromit rrezikojnë falimentimin. Kjo situatë i ka shqetësuar biznesmenët e subjekteve të prodhimit të kromit Bulqizë, të cilët parashikojnë përkeqësimin e situatës financiare të kompanive që ata drejtojnë.

Muajt e fundit çmimi i mineralit të kromit si dhe kërkesa në treg është përgjysmuar si dhe kërkesa në treg ka pësuar një rënie të theksuar, duke qenë prej një viti shumë e ulët. Një situatë e tillë e konjunkturës së kromit në treg është prej një viti dhe vazhdon të përkeqësohet.

Çmimi prej një viti qëndron rreth 150 \$ deri 200 \$ për ton me 42 % Cr2O3. Aktualisht këto subjekte minerare janë në kolaps pasi nuk mbulojnë koston e prodhimit. Ndaj duke u ndodhur në këto kushte, subjektet po hasin vështirësi të mëdha në pagesën e faturave, pagave të punonjësve dhe

të detyrimeve tatimore, si dhe detyrimeve portuale.

Të gjithë subjektet janë detyruar të marrin kredi dhe overdraft në banka të nivelit të dytë, me qëllim që të mbajnë punëtorët në punë, gjithmonë duke shpresuar që të ketë rritje çmimi. Kjo situatë tashmë i ka goditur dhe i ka zhytur në borxhe, duke vazhduar shitje të materialit të kromit të prodhuar nën kosto. Meqenëse kjo situatë zgjati, tani administratorët pretendojnë ose të ulin pagat e punonjësve, ose të shkurtojnë fuqinë punëtore.

Nga ana tjetër këto subjekte po përballen me kontrole të shpeshta shteti, nga mjedisi, AKBN, transporti rrugor dhe tatimet. Që nga data 20 e çdo muaj ka presion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo Rajonale për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe të kësteve paraprake të tatim-fitimit. Ata e bëjnë këtë me qëllimin e realizimit të planit, ndërsa subjektet nuk paguajnë dot pagat. Në këto kushte këto subjekte janë në sit-

uatë falimentimi, prandaj kërkojnë që këstet e tatim-fitimit të mos i paguajnë dhe të mos penalizohen për këtë, pasi janë parapagime.

Duke analizuar shitjen dhe normën e fitimit këto subjekte ekonomike nuk arrijnë tatim - fitimin e vitit të kaluar. Ato janë të bindur se po ju bëhet një padrejtësi. Ndaj janë të mendimit që t'u bëhet një marrëveshje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për pagesën e sigurimeve, për një afat 6 mujor. Kjo marrëveshje zgjidh krizën financiare dhe sociale duke mbajtur numrin aktual të punonjësve, për të mos shkurtuar vendet e punës ku humbin pagesën mijëra familje. Njëkohësisht këto subjekte kërkojnë nga qeveria që kontrollet të mos ju bëhen pengesë në realizimin e punës dhe të prodhimit.

Një nga problemet më të rëndësishme që e kanë ngritur edhe më parë por që tani merr rëndësi të veçantë është rishikimi i pagesës së rentës minerare që të mos paguhet për një periudhë të caktuar.

Kërkesa e kompanive konçensionare të nxjerrjes dhe përpunimit të kromit, veç të tjerash konsiston që të ndërhyhet në kompanitë e përpunimit të kromit në port për uljen e tarifave për një periudhë deri sa të lëvizë tregu, pasi ka një vit e gjysmë që përballemi me këtë situatë të rëndë dhe tani po paralamërojmë kolapsin e plotë. Ato i bëjnë thirrje qeverisë që t'i mbështesë me masa konkrete për të mos falimentuar dhe për të mos rënë në mbyllje të plotë pasi do të ishte një humbje e madhe për ekonominë shqiptare.

Në qarkun e Dibrës industria minerare zë një peshë të konsiderueshme në të ardhura ekonomike dhe me

kontribute të mëdha në tatime.

Duke shpjeguar më në detaje, administratorët e këtyre subjekteve shprehen se konkretisht zgjidhja duhet të vijë në një qëndrim për biznesin minerar në shkallë kombëtare, pasi këto probleme nuk janë vetëm për Bulqizën por për mbarë vendin.

Më konkretisht dhe në mënyrë të përmbledhur kërkesat janë si më poshtë:

- Të hiqet ose të ulët në 2 % renta minerare.
- Të ulen shpenzimet portuale.
- Të mos vihen sanksione tatim-fitimi

Për ta ilustruar në shifra mund të thuhet se situata është kjo:

Kostoja e prodhimit për një ton krom është 120 \$.

Nga prodhimi te pika e grumbullimit kostoja shkon 6 \$ për ton.

Transporti nga sheshi i grumbullimit deri në Durrës kushton 14 deri 20 \$ për ton.

Pas kësaj të gjitha shpenzimet portuale deri në ngarkimin në anije kushtojnë 18 deri 20 \$.

Renta minerare varion sipas cilësisë nga 12 deri 25 \$ për ton sipas referencave.

Llogaritur këtu edhe derdhjet tatimore, dhe kalon 191 \$ për ton, kur dihet se çmimi për 1 ton është 150 dollarë.

Aktiviteti prodhues po shkon në humbje dita-ditës sepse kromi nuk është 42 % dhe humbjet janë shumë të mëdha, pasi për 36 % humbja shkon në 60 \$ për ton. Për çdo 1 % humbjet janë 10 \$ për ton. Ndaj kompanitë dalin me humbje dhe kështu këto subjekte, po nuk u ndihmuan nga shteti detyrohen të mbyllin aktivitetin prodhues i cili po shkon në humbje dita-ditës.



Ç'janë këta kanibalë, të pamëshirshëm, grabitqarë që u marrin ujin e pijshëm e për ujitje fshatarëve, pa pyetur askënd?!

investigimi

Hijena shporrëni, ujin do e mbrojmë me gjokset tona

DR. SELMAN MËZIU

A janë krijuar legjenda nga më drithërueset, me flijime jetësh për ujin e pishëm e vadën e tij? A thuhet nga goja e popullit e ruajtur e pashuar, bres pas brezi, se ku ka ujë, ka jetë njeriu, kafshesh, shpendësh, bimësh etj.? Njihen me dhjetra legjenda mbi vlerat e domozdoshmëria e të jetuarit pranë ujit me plotë sakrefica, heroizma, dhe me mjeshtri ruajtje, transportimi, kanalizimi etj.etj.

Sa rëndësi ka uji duke marrë si shembull funksionin biologjik të trupit të njeriut:

Uji ka një rol tepër të rëndësishëm në funksionimin e organeve vitale. Trupi ynë përbëhet nga 55-75 përqind ujë, prandaj edhe kemi aq shumë nevojë për të. Mesatarisht, njeriu duhet të pijë rreth 2 litra ujë në ditë. Ndërsa ka disa dhjetëvjeçar, vite që në shqipërinë, të ashtuquajtur demokratike, njerëz të caktuar, krejtësisht të xhveshur nga tiparet, apo karakteristikat kryesore që e ndryshojn nga gjallesat e tjera: Ndërgjegjja, gjykimi, për të fituar para, për të lumturuar veten. Janë ato që veprojnë si kanibal, të pamëshirshëm, grabitqarë, duke ju marrë ujin e pijshëm e për ujitje fshatarëve, pa pyetur askënd.

Këto planprishës, kriminel, hajdut të stërholluar, janë kthyer në kulçedra e dragonj të zinj nga veprimet, gjykimet dhe ndjenjat e tyre tanimë 'kanibaleske'. Por, këto lloji banditësh kanë krahët e ngrohta, kanë mbështetjen e fuqishme ose të deputetëve, ose të ndonjë anëtarit qeverie apo politikani të fuqishëm të cilët luajn tragjedinë më të tmerrshme mbi natyrën shqiptare, lumenjtë prrenjt, burimet e ujrave të pishëm, jetës së malsorëve etj. Që nga ujëkthjellta Valbona, Cemi dhe deri tek Vjosa e Drinoja në jug të shqipërisë që po lëngon, vuan dhimbshëm nga shkatërimi i natyrës, nga zhdukja e mijëra gjallesave, nga shkretizimi e tharjet e shtretërve të përrnjëve, burimeve e lumenjëve. Ku nuk njihet as ligji, ndërsa shteti sigurisht është bashkëpunues i heshtur me ndërtuesit, ndërsa gjykatat janë krimbur këmbë e kokë nga bakshishet me miliona lek, siç është së fundi vendimi i gjykatës së Tiranës mbi hidrocentralin në ujëmbledhësin e Melthit e Zall Gjoçajt në favor të pashallarëve të rinj.

Pikërisht janë këto veprime shtazarake grabitëse që i kanë detyruar fshatarat e Lamit të Madh, Melthit të Ko-



leci, Zall Gjoçaj të futen në grevë prej dymbëdhjetë ditësh. Sa i pa përfytyrueshëm është agresioni i tyre, sa që kanë betonizuar, po e futin në tuba të çeliktë e puseta "kroin e Kolës", që ndodhet në udhën këmbësore që shkon nga fshati malor Lami i Madh (975 metra mbi nivelin e detit) për në Melth e Zall Gjoçaj (897 metra mbi nivelin e detit), i cili ka mijëra vjet, që buron i qetë, i dobishëm, jetëdhënës, në mes të shkëmbinjëve të thepisura gëlqerore. Ku natyra ua ka bërë dhuratë këtyre malsorëve krenar trima, të pamposhtur, punëtor, të ndershëm këtu në mes vargmalit hijerëndë të "Dejës së Matit" dhe majës kryeneçe të "Ksulës së Zezë", e vargut hijerëndë e madhështor të "kreshtës së Lurës".

Pankarta e banorëve të disa fshatrave të Matit, për ndalimin e punimeve për ndërtimin e HEC-it në zallin e Melthit.

Pa mëdyshje betonizimi i këtij burimi uji, nuk do të ketë mundësi jetese për 500 fshatar të Lamit të Madh dhe të 100 të fshatit Melthi i Kolecit. Natyrisht gratë, vajzat, nënat, me bulëra prej druri, kanë shekuj e shekuj të ngarkuar, ndoshta me kambët zbatuar ose me opinga, në acarin e dimrit akullnajor ose të vapës së gushtit që çan gjurin në dysh, mbushin ujë të ftohtë

për të pirë e gatuar për fëmijët e familja e tyre, duke ruajtur vazhdimësinë e brezave, përmes vuajtjesh makabre, mjeruese, të dhimbshme, prej qindra e qindra vjetësh. Mbijetesa në prehërin e maleve, me burimet jetëdhënëse të tyre, me ngrohtësinë e bujarinë e pyjeve kullotave, përrnjëve e burimeve të pakta.

Çdokush qytetar i thjeshtë, poet apo shkrimtar, akedemik, pyet me plotë kureshtje: "A kemi ndonjë burim historik mbi këto fshatra, mbi jetëgjatësinë e këtyre ngulmimeve etj?"

Pa u zgjatur do t'i drejtohem librit me dokumenta të shekullit të pesëmbëdhjetë, të Selami Pulahës, i cili në regjistrin e popullsisë të marsit të vitit 1467 shkruhet: "Fshati Melth, Fshatarët: Peter Kalanezi, Marko Kola, Peteri biri i të sipërpërmendurit, Ilija Gjoni, Gjoni i biri i të sipërpërmendurit, Gjergj Suma, Budini i biri i të sipërpërmendurit, shtëpi (7)".

Pra pa hyrë në thellësi të historisë së këtyre fshatrave, nga ky shekull, pse jo edhe më të hershëm, dalim fshatra së paku mbi pesë qindë vjeçar, që vazhdojnë të ushqehen nga toka e pakët bujqësore, pylli i tyre, blektorja, bulmetrat, prodhimet e tjera nga kjo tokë dhe nga ky burim uji. Ndoshta edhe emri i kroit e ka filluesin e emërimit nga ky fis me mbiemrin Kola.

Kuptohet qartazi, se sa tragjike, sa e hidhur, sa e përmotshme janë veprimet e kulçedrave moderne me fytyrë e mendësi të ashtuquajtura njerëzore. Pra në vitin 2019, kërkojnë zhdukjen e këtyre fshatrave, jo armiqtë gjakatar, turq, serb, gotët, hunët, mongolët, romakët etj., por, pjellat shqiptare, të politikanëve të pangjishëm, agresor të pushtetarëve të këtyre tridhjetë vjetëve. Drejtpërsëdrejti të anëtarëve të qeverisë së Edi Ramës. Me metoda të stërholluara mashtrimi, lakmish, gënjeshtrove, premtimeve duke u'a marrë shpirtin dalëngadalë e zhdukur me plotë dhimbje, këputëse shpirti e sflitje fizike nga trojet stërgjyshore.

Banorët janë të shqetësuar se hidrocentrali i Sekës do fusë në tub prurjen e lumit dhe do shterojë burimet ujore për 13 fshatra dhe mijëra banorë. Foto: Sami Curri/BIRN

• Po perifrzoj një kumt të shkrimtarit, gazetarit e poetit Ymer Keta, i cili më shkruan: "S'po kuptoj asgjë ç'janë këto lloj specimesh që i bien ndesh natyrës dhe njerëzve të thjeshtë, që mbajtur me buliera, për të rritur fëmijët. Edhe bagëtisë veç kur të bien në zall të Melthit. Unë kam njohje të thell për atë zonë, pasi kam shërbyer mbi 6 vite. Nuk e kuptoi si mund të lihen pa ujë ata njerëz të mrekullueshëm. Zoti i'u lëshoftë mallkim atyre që, për të fituar shuma të mëdha parash lenë ata fshatare pa ujë, pa jetë."

Këto fshara, malsor, që përpiqen të jetojnë me ndershmëri, me përpjekje të mundimshme. Janë pikërisht këto që mbajn të gjalla, traditat, vend filluesin e qytetërimit, duke i shtuar gjallërinë natyrës me veprimtarinë e tyre energjike, punën e lodhshme të çdo stine, prodhimin bujqësor e blektoral me dinamizëm, këtyre trevave peisazhe mahnitëse e mrekulluese, të një populli bujar, të thjeshtë, krenar, të sakreficës.

Duke luftuar pa u ndalur, si heronj të vërtetë duke jetuar si "krimbi nën gur". Këto përbindsha njerëzore me gjak shqiptari, kërkojnë të zhdukin çerdhet e malësorëve qindra vjeçar, armiqtë e rinj, bajlozët, oligarkët qeveritar, shushunjat e tyre vdekjeprurëse që mbajn pas vetes.

Fitorja do të arrihet, kur mbrojtja e tyre do të jetë stoike, e pathyeshme, të bashkuar si vargmalet rrethuese, me programe të qarta, me veprime korrekte, plotë zgjuarsis e diplomaci. Kjo lloje mbrojtje ngujimi deri në sakrifikim jete, do të hyjë në epopet legjendare të mbrojtjes së ujit të pijshëm. Nuk duhet t'iu besohet deri kur ministria Balluku e Klosi të dalin me deklarata e vendime të përbashkëta mbi ndalimin e punimeve dhe rregullimin e krojeve me gur të gdhendur si kerkesë ndjese për dhënie e lejes ndërtimore të hidrocentralit.

Po e mbyllim shkrimin me një kumt të shkrimtarit, gazetarit e poetit Ymer Keta i cili më shkruan: "S'po kuptoj asgjë ç'janë këto lloj specimesh që i bien ndesh natyrës dhe njerëzve të thjeshtë, që mbajtur me buliera, për të rritur fëmijët. Edhe bagëtisë veç kur të bien në zall të Melthit. Unë kam njohje të thell për atë zonë, pasi kam shërbyer mbi 6 vite. Nuk e kuptoi si mund të lihen pa ujë ata njerëz të mrekullueshëm. Zoti i'u lëshoftë mallkim atyre që, për të fituar shuma të mëdha parash lenë ata fshatare pa ujë, pa jetë."



Fshati Zogjaj pa mjek

Janë me dhjetra shembuj që dëshmojnë fallsitetin e premtimeve të bujshme elektorale të kësaj mazhorance për “shëndetësi falas”, Veçanërisht fshatrat e zonave malore ndjehen më të braktisur se kurrë.

Kjo godinë që shihni në këtë foto ndodhet në fshatin Zogjaj të Bulqizës. Ajo u ndërtua për tju shërbyer mijëra banorëve si spital, por nuk e kreu asnjëherë funksionin e saj. Kryetari i Fshatit Zogjaj, Naim Lleshi thotë për Tv “Bulqiza” se dikur në këtë fshat kishte spital të rregullt, madje edhe maternitet, por që pas viteve 90-të është shkatërruar çdo gjë. Sipas Lleshajt jo që nuk ka më spital në fshatin Zogjaj, por nuk ka as një infermiere për të bërë një gjilpërë. Banorët e fshatit Zogjaj në Njësinë Administrative Shupenzë në Bashkinë e Bulqizës kërkojnë që në fshatin e tyre të rikthehet shërbimi shëndetësor.

ZOGJAJT KANË INFERMIER POR BANON NË SHUPENZË

Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në Bulqizë, Flamur Meta ka reaguar në lidhje me shqetësimin e ngritur nga banorët e fshatit Zogjaj të Njësisë Administrative Shupenzë të cilët u shprehën se janë pa shërbim shëndetësor. Meta tha se për këtë fshat është një infermier, që shkon nga Shupenza deri aty për të kryer shërbimet e nevojshme të banorëve. Por sipas tij, në fshat nuk ka patur një person me arsimin përkatës për ta punësuar, prandaj është marrë nga Shupenza. Sa i përket godinës që dikur ishte spital, Meta tha se është e pamundur që ajo t'i rikthehet funksionit të saj për shumë arsye. Mjaftojnë qoftë edhe vetëm këta



shembuj për të konkluduar në fallsitetin e premtimeve të bujshme elektorale të kësaj mazhorance

për “shëndetësi falas”. Veçanërisht fshatrat e zonave malore ndjehen më të braktisur se kurrë.

Ministria e Energjitikës, gjatë dhënies së lejeve nuk ka marrë në konsideratë ligjet për mbrojtien e mjedisit dhe zonave të mbrojtura

KE: Vala e HEC-eve të reja, politikë e gabuar, po dëmton rëndë turizmin dhe bujqësinë



Vala e lejeve për të ndërtuar HEC-e të vogla me koncesion po e dëmton zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, sidomos sektorët e turizmit dhe bujqësisë. Në një analizë të posaçme për programin e reformave ekonomike në Shqipëri 2019, Komisioni European vlerësoi se qeveria e Shqipërisë po i ndërton këto HEC-e duke shpërfillur rreziqet që ata krijojnë në mjedis.

“Qeveria planifikon të rrisë gjenerimin e energjisë nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të reja. Këto objekte po shkaktojnë shqetësime serioze në ndikimin në mjedis dhe kanë efekte negative të mëdha mbi komunitetet lokale dhe për turizmin” thuhet në dokumentin që Komisioni European lëshoi së fundi për reformat ekonomike në Ballkanin Perëndimor.

Duke marrë në konsideratë rritjen e pritshme të turizmit dhe intensifikimin e sektorit bujqësor, si dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike, burimet ujore të

Shqipërisë do të vihen nën presion nga HEC-et. Prandaj, sipas Komisionit është e nevojshme që Shqipëria të zgjerojë qasjen e saj strategjike duke e diversifikuar prodhimin e energjisë elektrike, duke rritur investimet në prodhimin e energjisë diellore dhe të erës, si dhe të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse të menaxhimit të ujit.

Një studim në terren vitin e kaluar i 20 ekspertëve të atashuar nga PNUD (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara) ka vërejtur një situatë alarmante në të gjithë procesin që shoqëron ndërtimin e HEC-eve që nga momenti i dhënies së lejeve, planifikimit dhe ndërtimit.

Dëmet më të mëdha janë bërë në zonat e mbrojtura, pasi aty dendësia e lumenjve dhe ujërave është e madhe. Në zonat e mbrojtura aktualisht kanë përfunduar punimet dhe janë në operim 26 HEC-e, 16 të tjera janë në proces ndërtimi dhe 105 të

tjera kanë marrë lejen.

Inspektimi në HEC-et e përfunduara, i pari i këtij lloji nga një ekspertizë e pavarur ka gjetur se pjesa e dërrmuese e objekteve janë ndërtuar pa respektuar standardet mjedisore dhe ato për mbrojtjen e faunës. Kushtet për vendkalimin e peshqve nuk janë marrë në konsideratë dhe kriteret për rehabilitimin e mbeturave dhe rivitalizimin e zonës pas punimeve nuk janë bërë.

Grupi i ekspertëve inspektoi në terren të 71 HEC-et e ndërtuara tashmë dhe shqyrtoi anën ligjore për mbi 520 lejet e dhëna. Në përfundim të kërkimeve ata kanë formuluar rreth 30 rekomandime, të cilat ia ka vënë në dispozicion Ministrisë së Energjitikës për të përmirësuar sado pak situatën.

Ekspertët kërkojnë që të mos ndërtohet asnjë HEC tjetër në zonat e mbrojtura. Nga verifikimet në terren ata gjetën se, pothuajse të gjitha HEC-et kanë krijuar erozion dhe në të ardhmen pritet të sjellin kosto të mëdha financiare në buxhetin e shtetit për të menaxhuar pasojat negative në vijimësi.

Gjithashtu ekspertët vërtetuan se Ministria e Energjitikës, gjatë dhënies së lejeve nuk ka marrë në konsideratë ligjet e tjera në fuqi për mbrojtien e mjedisit dhe zonave të mbrojtura.

Gjithashtu ata verifikuan se Shqipëria ka shkelur edhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që i ka nënshkruar më parë. Sipas tyre lejet për ndërtimin e HEC-ve janë dhënë pa analizën kosto përfitim, por të shtyra nga logjika e plotësimit të kërkesës për energji dhe nevojës për të hapur fronte të reja për biznes.

/Revista Monitor/

Tregu i Shupenzës pa asnjë kusht, fermerët ankohen edhe për mungesë të shitjes

Dhjetra fermer të fshatrave të Dibrës e Bulqizës mblidhen çdo të dielë në Shupenzë për të tregtuar prodhimet e tyre. Por ndonëse ky është një ndër tregjet tradicionale të zonës i cili është përdorur prej dekadash, askush nuk ka menduar për përmirësimin e kushteve të tij, duke i lënë fermerët në qiell të hapur. Megjithëse nuk kanë kushte, vetë tregtarët thonë se paguajnë taksën sa herë që dalin aty. Por si të mos mjaftonin kushtet skandaloze ku ata tregtojnë prodhimet e mbledhura gjatë këtij vitit, fermerët thonë se po përballen edhe me mungesë të fuqisë blerëse e kjo ka bërë që çmimet të jenë shumë të ulta. Tregtarët thonë për Tv “Bulqiza” se çmimi i shumë produkteve ka rënë ndjeshëm, duke mos mbuluar as koston deri në prodhim.



Për romanin autobiografik "Krom dhe luledele" të
Elsa Skënderi Rakiplarit

reçensa

E NJË GJAKU ME ËNDRRËN.....

AGRON TUFA

Nëse Elsa Skënderi Rakiplari (me gjithë kompleksitetin e autorësisë), për hir të një trilli të befte do të kishte parapëlqyer, që ta ndryshonte "unin" e vetës së parë rrëfyese në prozën e saj të gjatë "Krom dhe luledele" me neutralen "ajo" të vetës së tretë, atëherë, jashtë çdo dyshimi, do të kishim të bënim me një roman. Madje në përputhje të plotë me natyrën dhe ligjet narratologjike që përcakton zhanrin e romanit, sikurse na paraqitet përnjëmend proza e saj, me strukturimin kompozicional me një prerje kronotipike, ku mbruhet pak e fije personaliteti fëmijor i shkrimtares së ardhme. Përpikmërisht këtë na vërtetojnë dhjetra përvoja letrare në krijimtarinë e shumë shkrimtarëve, madje, përveçmas, në veprat e tyre të para. Kjo instancë rrëfimore neutrale, sikurse është funksioni i përemrit vetor të vetës së tretë njëjës "ajo", do ta përligjte kushtin teorik për të konsideruar në formë e në përmbajtje (në sintaksë e semantikë) një roman, vepër mirfilli letrare, një nga ato lloje romanesh të natyrës (auto)biografike, që quhen rëndom "portret artistje në vegjëli".

Mirëpo Elsa nuk e bën këtë. Ajo mbetet te "uni" i saj, qartësisht i shpallur dhe i identifikuar me emër. Ajo nuk e ka aspak hallin të narrativa për të tjerë, sepse Elsës i intereson filli lidhës i identitetit vetjak, e asaj pjese, ku nis të ngjizet legjenda metafizike e misterit të "unit", diku, në kohë e hapësirë. Dhe këtë fill lidhës ajo e bën përmes gjuhës (rrëfimit), me një tipologji shkrim të imët, të dendur, intim, gjithnjë përmes magjisë e habitës së gjuhës. Është gjuha që ajo, jo pak herë e rizbulon me variantet e gojëfoljeve lokale, dialektore, në shprehjet, ngjyresat, metaforat, pasthirrat dhe lokucionet krahinore, si projektion psiko-mental të mjedisit të ashpër urban, në atë trekëndësh provincial Bermunde të Veri-Lindjes sonë.

Ashtu siç lidh malet personazhi fantastik në përrallën magjike që rrëfen Tota (gjyshja), duke u kaluar atyre një litar (fill), si të ishin rruazare, ashtu dhe rrëfimi i Elsës kalon në fill skaje e momente të identitetit të saj nga mituria, deri në epilogun e largimit, në klasë të dytë. Përftohet kështu "rrethi i identitetit të saj" me unitet kompakt, që nëpërduket në raportet dhe projektionet e saj të brendshme me veten dhe botën. Dhe kur kupton se po larg-



ohet përfundimisht prej atij habitati ("vendi i dajakut") ku u formësua ky rreth i identitetit të saj, sërish ai na paraqitet i kompaktësuar në trajtën e një "byzyliku me petale bojëqielli", të cilin Rrëfimtaria (Elsa) e shpërndan, duke i dhuruar secilit bashkënxënës nga një petale të kristaltë nga ky byzylik. Çfarë mbetet? Vetëm rrethi bosh që i kishte bashkuar ato petale, d.m.th., filli lidhës, uniteti përbashkues i të gjithave e gjithçkaje që na rrëfehët.

"Krom dhe luledele" është një prozë plotë xixëllima (ashtu si gurët e kromit, që kanë vlerë tjetër e janë më të rëndë midis gurëve të zakonshëm).

Gjuha e (auto)rrëfimit në këtë tekst proze të gjatë është gjuha plot sharm, ironi, përsiatje paradoksale e tutologji infantile me përshkrime të imëta lirike e poetike, detaje skrupuloze, skena e situata të thukëta, të përcjella me vetëpërmbajtje ironike e koprraci të ndershme. Dominantja e këtij ligjërimi është letrariteti i spikatur, që e lejon atutoren të çajë thellë në aventurën e saj të rizbulimit të Kohës dhe Gjuhës, për të ringjallur edhe një herë rrjedhën e viteve, qenien e vet të dikurshme brenda asaj guacke molusku, që tashmë qëndron aty, endur me rrrathë të sedeftë.

Kjo botë e trazuar që kundrohet me sytë infantile, në një qytet thujtë të braktisur minatorësh (Bulqiza), ku çdo gjë është e dyshimtë, ambigue, me shkallët e larta dhe idolin modern skulptural e socrealist të përmendores së Minatorit, i cili rri i shastisur e qyq mes një peisazhi urban, që i ka humbur tashmë referencat, bëhet qendër e një organizimi të dyshimtë psikik në raportet e fëmijës me botën (jashtësinë). Bota brenda (përbrenda) dhe bota

jashtë (përjashtë) – janë një dikotomi që përpiqet, por nuk ia arrin të zbutet, ndërkaq, tok me rritën, vetëdija e vajzes së vogël me imagjinatë jashtëzakonisht pjellore e të uritur, meton t'i shndërrojë realitetet dhe raportet e njerëzve me to, vijnë duke u majisur, ndërsa vajza e vogël jeton stinën e zmadhimit të syve: habitë janë të pashtershme, andaj vogëlushja përpunon mënyrat e saj, diqysh t'ia dalë mbanë, të çlirohet nga frika somatike e gjësendeve, duke i ç'magjepsur ato nga energjia e keqe përmes sajësës, emërtimit. Kështu, pak e fije, ajo arrin të ndërtojë farë kozmosi të saj, si të ishte në fazën mitologjike të njerëzimit. Prapa shtëpisë, përtej një kopshti të vogël, ajo kuvendon heshtazi me Stokun, në gjuhën e saj, derisa më vonë qielli i shfaq "zbulësën" e Zotit, që për dreq, rezulton të jetë konstrukt i një antene në majëmal.

"Krom dhe luledele" pra flet për një vogëlushe dhe rritjen e saj mes kozmosit shpirtëror shtëpiak dhe një qyteti të flimentuar minatorësh, të varfër, të ashpër e të ftohtë, ku jeta është pështjelluar në një nyje të ankthshme paralize, ndërsa perspektiva e së ardhmes pushtohet nga gjëmimet, kallashët dhe tragjeditë e vitit 1997. Brishtësia e fëmijëve që rriten është si brishtësia e "luledeleve", që sado të rritura më frymën e ngrohtë të dashurisë prindërore, përmes sakrificash e mungesash, zor se do t'i mbijetojnë peisazhi inorganik alien, që paraqet qyteti minator.

Rrëfimi i Elsës përshkallëzohet me dendësimin e simptomave të alarmit, ankthit e panikut, deri në kulmin e pëzishëm të dëshpërimit, zisë e vjatimit. Fëmija rritet, ndry-

• "Krom dhe luledele" është një prozë plotë xixëllima (ashtu si gurët e kromit, që kanë vlerë tjetër e janë më të rëndë midis gurëve të zakonshëm.... Ashtu siç lidh malet personazhi fantastik në përrallën magjike që rrëfen Tota (gjyshja), duke u kaluar atyre një litar (fill), si të ishin rruazare, ashtu dhe rrëfimi i Elsës kalon në fill skaje e momente të identitetit të saj nga mituria, deri në epilogun e largimit, në klasë të dytë. Përftohet kështu "rrethi i identitetit të saj" me unitet kompakt, që nëpërduket në raportet dhe projektionet e saj të brendshme me veten dhe botën

shojnë vendet e banimit, format e arsytimit, raportet me njerëzit, botën, rritet nostalgjia, rritet mosbesimi përsa bota bëhet më e pasigurt, më e trazuar, duke u rrokullisur drejt protestës, destruktivitetit të pakontrollueshëm dhe dëshpërimit pa rrugëdalje. Kronologjia e ngjarjeve është e mbushur me episode, personazhë e ngjarje tragjike: xhaxhai emigrat kthehet me "vete të humbur", prej përvojave të pariparueshme të dhunës; banditët vërshojnë në rrugë; armët hyjnë në për shtëpi, në duar të fëmijëve loja e birit me armë vret një nënë ("Omeri vret Ajkunën"); qeni angullin përvaishëm e këmbëngulës te porta dhe, sipas superticionit, dikë të afërt në atë shtëpi e merr; edhe në repertorin e shenjave tradicionale të zisë dhe vajtimin, dikush mjeron e pikëllohet, dikush tjetër shtiret e luan komedi. Por kutesa dhe vëzhgimi i fëmijës mbërthehet pas detajeve, pas gjendjeve dhe raporteve të reja, të cilat i fikson si përvoja të para, që lënë gjurmë: "Kisha kuptuar se vdekja ishte e frikshme, rrëgjuese; se shkohej në tokë dhe jo në ndonjë qiell. S'di në ishin rrekur të më mbushnin mendjen ndonjëherë për ndonjë lartësim drejt Zotit, por të njëjtin botëkuptim me timin duhej të kishin pasur edhe fëmijët paganë dikur atyre anëve".

(vijon në fq.11)

Skënder Cala - "Mjeshtër i Madh", në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare

• Ky event i organizuar nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" dhe Shtëpia Botuese "M & B" të dielën e 10 Nëntorit, u moderua me mjeshtri të rrallë artistike nga prof.dr.Bujar Kapexhiu - "Nderi i kombit"

SAKIP CAMI

Me prezencën e ish-Presidentit Bujar Nishani dhe të elitës së artistëve të skenës, ekranit e muzikës, si: Robert Ndrenika, Guljem Radoja, Dervish Biba, Zef Çoba, Edmond Zhulali e Arif Vladi u promovua libri i 15-të i publicistit dhe shkrimtarit Halil Rama, "Në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare". Ky libër i kushtohet artistit të mirënjohur Skënder Cala, regjizor, këngëtar, aktor, që ka interpretuar përkrah të mëdhenjve Sandër Prosi, Marie Logoreci, Stavri Shkurti, Rajmonda Bulku, etj, në filmat e ish-Kinostudio "Shqiperia e Re", "Skënderbeu", "Çeta e Vogël", "Bardhësi", "Përballimi", "Kërcënim", etj., që ka themeluar Teatrin Profesionist të Peshkopisë ku ka vënë me sukses dhjetra premiera si regjisor dhe aktor, në kuadrin e 80-vjetorit të lindjes.


Me këtë rast në sallën e madhe të Muzeut Kombëtar, qindra personalitete të artit, kulturës e letrave ndoqën me interes e vëmendje edhe dokumentarin me të njëjtin titull të autorit Halil Rama. Dokumentari që mjaftë mbresëlënës për faktin se artistë të njohur evidentonin vlerat e Skënder Calës si këngëtar, regjisor e aktor, ndërsa në mbyllje jepën çaste

nga dekorimi i tij me titullin "Mjeshtër i Madh", ku Presidenti i Republikës Bujar Nishani, pasi vlerëson aftësitë artistike dhe ato njerëzore të këtij artistit që janë shijuar edhe vlerësuar si brenda edhe jashtë vendit shprehet se: "Vlerat e Skënder Calës shkojnë përtej kontributit të artit shqiptar. Ai mbi të gjitha kontribuoj në zbulimin e artistëve të rinj, i cili i përgatiti duke ju dhënë shumë nga vetja e tij, në mënyrë që ato të ishin të përgatitur për të konkuruar në skenën e artit shqiptar por edhe më gjerë. Dhe sot ata, duke ecur në hapat e mjeshtrit të tyre, profesorit të tyre kanë një emër në jetën artistike si brenda ashtu edhe jashtë vendit".

Ky event i organizuar nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" dhe Shtëpia Botuese "M & B" të dielën e 10 Nëntorit, u moderua me mjeshtri të rrallë artistike nga prof.dr.Bujar Kapexhiu - "Nderi i kombit".

Për vlerat e librit dhe të dokumentarit folën: znj.Dhurata Çupi – ish deputete e PD, piktori i mirënjohur Buron Kaceli – ish nënkryetar i Bashkisë Tiranë; administratori i Shtëpisë Botuese "M&B" Bujar Karoshi, redaktori i librit Ramazan Kica dhe recensentja dr.Gidiola Hysa.

Pas interpretimit të këngëve me



motive dibrane nga këngëtarët e talentuar Vera Laçi e Sherif Dervishi, pjesëmarrësit i përshëndeti protaagonisti i këtij eventi, artisti 80-vjeçar Skënder Cala. Ai tha se monografia "Në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare", veç të tjerash prezanton jetën artistike të një qyteti, në të cilin gumëzhuar qindra amatorë e profesionistë, që në 40 vite mbajtën gjallë jetën artistike të Dibrës në përgjithësi e të Peshkopisë në veçanti.

"Në këtë 80-vjetor të ditëlindjes time, Zoti më la dhe më freskoi memorien, për të dëshmuar për bashkëkohësit e mi artistë, që me kontributin, sakrificat dhe emocionet e tyre, bënë që Dibra të gëzonte në dekada, 4

trupa profesioniste: Estradën, Teatrin e Kukullave, Ansamblin gjysëm profesionist dhe në Maj 1984, Teatrin Dramatik – trupa artistike profesioniste këto që bënë emër edhe në shkallë Republike", tha ndër të tjera z.Cala.

Në këtë rast kaq solemn, ai u bëri homazh artistëve që nderuan vehten dhe Dibrën me artin e tyre, por që nuk i kemi më midis nesh: Shkonranit Tefë Krroqi, Tonin Rrota; Munir Shehu; Adil Shehu; Hazis Ndreu; Vera Nura; Hiqmet Elezi; Muharrem Zajmi; Fatime Bojaxhiu; Haxhi Mata; Bajram Mata; Izet Dardeshi; Xhevat Fana; Vëhap Isaku; Ymer Seferi. Duke mos u ndalur tek të gjallët artistë dibranë që kanë "pushtuar" skenat, jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit, Z.Cala falenderoi dashamirësit e tij, që me urimet dhe përgëzimet e sinqerta i ngrohën shpirtin në këtë 80-vjetor të ditëlindjes dhe të gjysëm shekulli martese me Ferihanë, njëkohësisht dhe bashkëpunëtore e tij.

Një falenderim të veçantë ai bëri për autorin e librit monografik Halil Rama – gazetar & publicist dhe prej disa vitesh shkrimtar – autor i 15 librave, në të cilët i bën jehonë historisë tonë, të luftimeve dhe të punës... dhe jo vetëm të Dibrës. "Falenderimi ndaj tij është i pafund, ashtu si kurse dashamirësia e tij për artistët e Dibrës, ka qenë dhe ka mbetur pa kushte dhe pa interesa. Urtësia e tij prej gjurmuesi e hulumtuesi ndaj vlerave kulturore, artistike dhe historike, bëri që me librat e tij të rrënjosen në memorien tonë përjetësisht dhe në funksion të edukimit të brezave", u shpreh "Mjeshtri i Madh" Skënder Cala.

Pasi falenderoi edhe shokët dhe miqtë që bashkëpunuan me autorin H.Rama dhe që ndihmuan që monografia dhe dokumentari të marrin jetë, ky artist i madh i skenës dhe ekranit, mes emocioneve të papërshkruara u shpreh se "Dashuria dhe përkushtimi i derdhur në faqet e këtij libri më shton adrenalinin për të qenë aktiv edhe në të ardhmen".

Apostull i oshtimës së vuajtjes dhe dhimbjes fisnike

Zoti Rama!

I nderuar mik!

Ju faleminderit!

Vepra juaj - të bëhet një investim ekonomiko-intelektual pa asnjë lloj mundësie përfitimi në sfond - flet sa vetë jeta. Aq më shumë kjo, në kuptimin e mundësisë ekonomike të jetesës - nga një njeri i zakonshëm. Realisht, unë nuk di, qoftë dhe një të vetëm rast të tillë si xhesti juaj. Keni faktuar që jeni apostull i oshtimës së vuajtjes dhe dhimbjes fisnike. Me veprën tuaj jeni ngjitur afër provanisë.

I nderuar mik!

Nën shtytjen e valës së emocionit të brendshëm, një mori pyetjesh dhe ankimesh më vërshojnë me aq vrull drejt gojës. Përballë jush, si pronarët e sarajeve të Plutonit, qëndron këshilli bashkiak Diber - jep tituj me prapaska të ndyra dhe bën "qytetar nderi" Kryeministrin, duke dëftuar që shprehja e At Zef Pllumit "Kaq shumë rrugaçë paska nxerrë ky popull i vogël", është e vërtetë. Ky këshill bashkiak më ka krijuar një lëmsh diku brenda, një lëmsh që sa më shumë më rritet ndijimi i pështirosjes për ta, aq më lart më ngjitet në grykë.

Jeta njerëzore nuk është gjë tjetër veçse bashkim i përkohshëm i shpirtit me materjen; por, fatkeqësisht, ndodh që shpirti në vend që të bashkohet normalisht me një materje, ai rrënohet duke rënë në një gërmadhë, me të cilën mbyll atë cikël. Na prekën në sedër miku im! Por

nuk është vetëm kaq; duke na veshur me turpin, i cili nga natyra është përvëlues, na kanë shkaktuar dhe dhimbje. Duke udhëtuar drejt të njëjtit hiç, sa larg jeni prej tyre miku im!, prej atyre që jeni mburjtur nga balta e të njëjtës tokë.

I nderuar mik!

Libri, duke qenë jehona më besnike e zemrës së atij që e ka shkruar, është e vetmja provë e shpirtit delikat që ka rrëmuar ndër thesaret më të pasura të dashurisë njerëzore dhe që bashkëron me kënaqësinë e të tjerëve. Aq më shumë kjo, sot, kur po përfetojmë fatkeqësinë më të madhe njerëzore - të mos ndërjetit e dashurisë. Shpejtësia e shkëmbimit të ndjesive në zemër, e cila është foleja e vetme e shpirtit, na bind se sa e shkurtër është jeta. Por ju, i nderuar mik, me këtë veprim, në këtë shkurtesë kalimtare, ia keni arritur të ndezni një flakë të vogël që xixëllon, e cila pret erën që t'i fryjë për ta gjallëruar; që të shuaj, sado pak, varfërinë shpirtërore që po kultivojmë. Duke të uruar si primum agmen, le të shpresojmë, që në këtë mision, të mos jesh Unkasi i mohikanëve.

Libri për Skënder Calën është shkruar dhe botuar nga Halil Rama, pa asnjë përfitim financiar, përveç sponsorizimeve modeste nga dy miq të nderuar të tij. Zoti Cala, sot është thjeshtë një pensionist i zakonshëm, ndërsa z. H. Rama, me këtë monografi e përjetëson Artistin - "Mjeshtër i Madh", në Panetonin e Vlerave.

Ramazan Kica, redaktori i librit.
Shtator, 2019.

Në këtë vëllim poetik, Barie Çupi shpalos dhe transmeton vlerat dhe shpirtin e saj krijues, dimensionin femëror

promovimi

U promovua libri me poezi "Vargonjte e fatit" i autores Bulqizake Barie Çupi

Tetori, muaji i letërsisë, u kujtua me aktivitete edhe në shkollën 9 vjeçare Shefqet Tançi në qytetin e Bulqizës, një nga shkollat me numër më të madh të nxënësve. Poetë nga Tirana si Kozeta Zavalani, Ilmi Dervishi, Anila Kodra iu bashkua dhe poetët bulqizakë Barie Çupi e Arben Alliu të cilët u pritën në Bibliotekën e shkollës nga drejtori i shkollës zoti Gazmir Sejdi. Krijuesit dhuruan librat e tyre por edhe 200 libra të tjerë të dhuruar për këtë shkollë nga poeti dhe këngëtar Naim Berisha e Nexhi Baushi, e të tjerë.

Në ceremoninë e dhurimit të librave përshëndeti dhe falënderoi kryetari i Bashkisë Bulqizë zoti Left-

er Alla, drejtori i shkollës zoti Gazmir Sejdi. Më pas në hollin e shkollës u promovua libri "Vargonjtë e fatit" i poetes Barie Çupi, një herësh mesuese e gjuhës frënge po në këtë shkollë. Libri është botuar nga Shtëpia Botuese M&B dhe redaktor i saj është poeti Ilmi Dervishi.

Për poezinë dhe vlerat artistike, tematikën e këtij libri më gjerë foli mesuesja e letërsisë Nafije Jella. Me interes u prit dhe diskutimi i poetes Kozeta Zavalani si dhe i mesuesve Gazmir Sejdi, Sami Cara, Vjollca Gjimi.

I pranishëm në këte aktivitet ishte kryetari i Bashkisë Bulqizë Lefter Alla. Aktiviteti u zhvillua në mjesdret e kesaj shkolle nën kujdesin e drejtorit të saj Gazmir Sejdi. Fillimisht aktiviteti nisi me një vizite për të gjithë të ftuarit në bibliotekën e shkolles, ku shkrimtarët dhe poetët i dhuruan kesaj biblioteke 200 libra në prozë poezi nga krijimtaritë e tyre. Me pas aktiviteti vijoi në një tjetër ambient të shkolles ku u prezantua botimi i librit të kesaj poeteje. Fjalën e

hapjes e mbajti drejtori i kesaj shkolle Gazmir Sejdi i cili në fjalën e tij përshëndetese theksoi rendesinë e botimit të kesaj veprë. Nderkohe të ftuarit ndoqën nepermjet monitorit çaste nga jeta dhe puna e mesuese Baries.

Një analizë me të gjere rreth vëllimit "Vargonjtë e Fatit" e bëri në fjalën e saj edhe ish mesuesja e letërsisë Nafije Jella, ku tha se poezia e poetes Barie Boba shperthen fuqishëm bashkë me ndjenjat e poetes. Pikerisht kjo ndjenje e bukur na fton ta lexojmë poezinë e saj, tha ajo. Shkrimtarja Kozeta Zavalani percolli ndjesitë e saj në pergjithësi, për poezitë e Baries, por në vecanti u ndal tek poezia "Faleminderit". Kryetari Bashkisë z. Lefter Alla duke

pasur në dorë librin me poezitë e poetes, përciell me se miri vlerën e poezive të saj, dhe duke i dhuruar surprizën që ja bënte të mundur Unioni i Shkrimtarëve duke e zgjedhur si "Anetare të Unionit Global" të poetëve shqiptarë. Mes emocioneve të saj, në këte ditë të shenuar të jetës, poetja ndjehet e vlerësuar për gjithshçka që u transmetua rreth veprës që ajo promovoi. Në fjalën e saj falënderoi të gjithë të ftuarit në këte event të rendesishëm. Mbresa dhe impresionet dhane mesues dhe ish mesues mbi jetën dhe veprën e poetes. Në fund të aktivitetit u shpërndanë certifikata mirënjohje shkrimtarëve të cilët dhuruan libra bibliotekës së shkolles



Poezia e Barie Çupit, fjala dhe vargu shpërthejnë fuqishëm bashkë me ndjenjat

NGA NAFIJE JELLA

Duke lexuar poezitë e këtij vëllimi, gjen aty pjalmin poetik, ku fjala dhe vargu shpërthejnë fuqishëm bashkë me ndjenjat e poetes.

Libri përbëhet nga 70 poezi, tematika dhe motivet janë kryesisht të planit shpirtëror, por ajo nuk le pa hedhur në vargje për vendlindjen, kujtimeve të fëmijërisë, qytetit minator, mallit për nënën si dhe tema sociale e shoqërore.

Titulli i librit është metaforik. Aty është rrëfim i vetë poetes në rrugëtimin e saj të përditshëm. Të kërkosh nëpër shpirt, të kërkosh brenda heshtjes dhe zërit tënd, t'i japësh jetë shpirt dhe zë poezisë në lidhjet e pazgjidhshme me të, do të thotë të japësh dhe të transmetosh dashuri në emër të jetës, përmes dallgëve, përjetimeve, tallazeve shpirtërore, brengave, maktheve

Në këtë vëllim poetik, Barie Çupi shpalos dhe transmeton vlerat dhe shpirtin e saj krijues, dimensionin femëror...

Fjala e saj ka hapësirë në poezi, ajo është dashuri, ajo e shenjtëron atë, e ruan si vlerë, në këto germa e fjalë, që janë aq të fuqishme, këput hallkat, fjetet e dukshme dhe të padukshme të vargonjve të fatit jetësor. Ajo thyen heshtjen. Ajo është zëri plot dritë, energji dhe jetë një luftëtare e fjalës së lirë...

Me një energji të brendshme shpirtërore ajo shpërthen, mallkon tokën metaforikisht, njerëzit si bartës të së keqes, padrejtësive, gënjeshtreve, hipokrizisë, dyfytërisë. Ajo kërkoi një botë që të triumfojë drejtësia, e mira e dinjiteti njerëzor, humanizmi, se vetëm dashuria mes njerëzve është ilaçi që rregullon botën në realitetin ku ne jetojmë sot.

Në disa poezi si "Rënie", "Radiografi

në sy të njerëzisë" ajo gjen forcën e arsyes që të ngrejë zërin të godasë në emër të të qenurit nënë, grua, motër, shoqe, femër tek kjo plagë që kullon në trup të njerëzimit, dhuna ndaj femrës, një dimension i egër klithmës ndaj krijesë me të mrekullueshme të gjithësisë...

Ajo i shkruan vendlindjes me të njëjtin mall që nuk i ndahet shpirti në gjithçka që ajo ka jetuar e përjetuar, por edhe përballë mentalitetit, egoizmit. E sheh veten ngushtësisht të lidhur me të, frymon me të dhe është bekimi i saj.

Malli dhe dashuria për nënën është e pashuar, është e shenjtë, ngren zemrën peshë.

Sado larg të jesh, ajo është dashuri mbi dashuritë, të shoqëron, kudo lëviz dhe shkon, është e vetmja qenie që të shpëton edhe në detin me dallgë...

Dashuria për poeten është një betejë në tërë qenien e saj si grua, si femër. Ajo e do atë të pastër, i qëndron besnike, ajo e gjeneron me forcën e shpirtit edhe kur ka dallgë edhe dhimbje bren-

da shpirtit të saj të trazuar e bën atë të bukur, të fuqishme.

Poezia e saj nuk i fsheh ndjenjat dhe emocionet, i shpreh bukur përmes përjetimit, bukurisë së shpirtit, madje edhe kur ka lot...

Loti, kjo ndjenjë e fuqishme si kristali! Sa mall, dashuri, ëndrra, lumturi, brenga, pengje, gëzime enden brenda tij, ku poetja e finalizon me mesazhin "se në çdo pikë loti do të thurë melodi, në atë lot ka dritë, ka jetë, ka shpresë ka gëzim".

Kopertina e librit e përçon dhe e përçakton më së miri në retinën e syve të dritës, ku ajo sheh qartë botën ku ecën duke sfiduar pengesat; se pa dashuri s'ka jetë.

Një pasuri tjetër e veçantë e këtij vëllimi është figurshmëria poetike, që është mjaft e pasur në universin e poezisë së saj, ku dominojnë figurat e kuptimit dhe të shprehjes, si metafora, metonimia, antiteza, krahasimi, anafora, përsëritja, enumeracioni e të tjera figura që i japin kolorit vargut të saj.



referati

LANÇ në Dibër” është libri që hedh dritë për ngjarje e fakte të mbetura disi në errësirë, ose të shtrembëruara qëllimisht e të pasyqruara si të tilla nga historiografia e viteve të para '90-tës.

Një ndër veprat më të arrira të publicistit, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami

“LANÇ në Dibër”, vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare

Halil Rama

“LANÇ në Dibër” është padyshim ndër veprat më të arrira të publicistit, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami, duke mbushur kësh-tu vaakumin e krijuar për një nga peri-udhat më të lavdishme të historisë së Shqipërisë. Ky libër që do të promovohet më 24 Nëntor 2019, ora 11 në një nga sallat e Muzeut Historik Konbëtar, i botuar në vigjilje të 75-vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist, hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë dokumentare.

Nëse i madhi, Prof.dr.Kristo Frashëri na la si trashëgimi veprën shumëdimensionale “Historia e Dibrës” nga lashtësia deri më 1939 (të cilën, ndoshta nga pamundësia moshore, apo nga ndikime të jashtme njerëzore, nuk arriti ta çojë më tej në periudhat e mëpasme historike), ashtu si dhe historiani ynë i shquar Moisi Murra, historinë e pesë viteve të okupimit nazi-fashist dhe të luftës së paepur kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij merr përsipër ta ndriçojë me fakte dhe argumente Sakip Cami.

Kur nisi punën për këtë vepër, duke e patur mik e bashkëpunëtor të ngushtë prej më shumë se tri dekada, miqësisht i thashë: “Kam besim të plotë në punën tuaj studimore, por shmangiu sa më shumë interpretimeve!”.


Por kur e përfundoi së shkruari dhe ma dha për redaktim, konstatova me kënaqësi kontributin e vyer të z.Cami për një vepër tejet dinjitoze.

“LANÇ në Dibër” është libri që hedh dritë për ngjarje e fakte të mbetura disi në errësirë, ose të shtrembëruara qëllimisht e të pasyqruara si të tilla nga historiografia e viteve të para '90-tës.

Në katër kapitujt e librit jepen detaje dhe fakte të panjohura për veçoritë e LANÇ në Dibër dhe në Dibër të Madhe, për formacionet luftarake dhe luftimet e zhvilluara, për heronjtë dhe dëshmorët sidhe lista e dëshmorëve të Dibrës sipas Arkivit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në tërësinë e fakteve dhe humbjeve të panumërta në njerëz dhe në materiale të një Evrope që u shkatërrua tërësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, S.Cami evidenton ato që ndodhën në Dibër.

Përmes faktesh të pamohuara, duke u ndalur veçmas në përcaktimin e kufijve kohorë të kësaj Luftë (Kufirin kohor e përcaktojnë ardhja dhe largimi i pushtuesve që është 7 prilli i vitit 1939 dhe ikja e tyre më 28 nëntor 1944) autori i kësaj vepre rendit ngjarjet në mënyrë kronologjike.



BOITIME TË AUTORIT SAKIP CAMI
POET, SHKRIMTAR, PUBLICIST

1. “Vërshimet e Drinit”, poezi, 1996.
2. “Karatesisti i Vogël”, vjersha për fëmijë, 2000.
3. “Ujëvara të përgjakura”, poezi, 2001.
4. “Daulja bie në ata që kanë veshë”, fabula dhe satira, 2003.
5. “Fshati i martirizuar”, monografi, 2004.
6. “Drejt NATO-s”, publicistikë, 2004.
7. “Rrëfime popullore dibrane”, 2006.
8. “Dibra në këngët dhe tregimet e popullit”, gjurmime folklori, 2010.
9. “Edhe unë kam të drejtat e mia”, vjersha për fëmijë, 2011.
10. “Muharrem Xhediku, kompozitor i tangos shqiptare”, monografi, me bashkautor, 2010.
11. “Rahman Parllaku, një legjendë në kufirin e dy kohëve”, monografi, me bashkautor, 2014, ripunuar në vitin 2019 “Gjenerali që sfidoi kohërat”
12. Skenar dokumentari TVSH: “Rahman Parllaku, një legjendë në kufirin e dy kohëve”, me bashkautor H. Rama Xh. Aliu, 2014.
13. “20 vjet OBVL”, monografi, me bashkautor, 2014.
14. “Bajram Ndreu i Zall Dardhës”, monografi me bashkautor, 2016.
15. “Kazazët e Durrësit”, monografi, me bashkautor, 2016.
16. “111 poezi” poezi të zgjedhura, 2016.
17. “Ngjarje dhe figura të shquara historike të Bulqizës”, 2017.
18. Refleksione fëmijërie, 2018.
19. Legjenda e një fisi të martirizuar, 2019.
20. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër dhe në Dibër, 2019

Çmimi: 1000 lekë

Brenda këtij kufiri kohor evidencim ngjarje dhe fakte, ku padyshim përveç tiparit çlirimtar të kësaj lufte që është determinant, nënvizon edhe tiparet e një lufte që u bë për pushtet, (që kurrësesi nuk mund të konsiderohet luftë civile) por pa e zbehur kështu tiparin e saj kryesor, atë çlirimtar e lirisdashës.

Mjaftojnë këto fakte për t’u bindur në konkluzionin se edhe në Dibër periudha e Luftës së II-të Botërore rezultojnë si periudha e konfliktit ushtarak më të përgjithshëm e më të përgjakshëm në historinë e njerëzimit, për të shuar sa më shumë jetë njerëzish si dhe për të shkatërruar sa më tepër vlera materiale, kulturore, etnografike, historike, e të tjera, të krijuara nga brezat njerëzorë ndër shekuj.

Sakip Cami këtë e bën më së miri nëpërmjet historisë së çetave luftarake (Të Dibrës e të Gollobordës), duke u ndalur veçmas tek Lufta kundër fashistëve italianë në Dibër; Lufta kundër nazistëve gjermanë në Dibër si dhe tek Lufta e njësive të mëdha partizane.

Ky është një kontribut i vyer i këtij autori, pasi si shprehet prof.dr.Bernard Zotaj në parathënien e librit, “... dibranët duan të mësojnë dhe ta njohin sa më mirë e deri në fund të vërtetën për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër. Njëkohësisht kjo etapë madhore e historisë, siç ishte antifashizmi shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, duhet njohur, studiuar, res-

pektuar dhe nderuar nga të gjithë me madhësinë e saj. Libri me dokumenta na çon në të vërteta historike të ndodhura në ato kohëra, sepse historia është ajo që ka ndodhur dhe kurrë nuk mund të mendohet si ajo mund të ndodhte me sikur, siç bëhet në këto vite të demokracisë. Historia është realiteti i kohës dhe nuk mund të themi kështu apo ashtu, e që nuk ndodhi, siç e mendojmë sot.

Autori i ka vendosur vetes për detyrë që nëpërmjet historisë të kësaj epoke të ndodhur në Dibër, të mësojmë që të ecim përpara dhe jo të kthehemi pas, duke harxhuar të gjitha energjitë se ishte apo s’ishte luftë civile, u vepua drejt apo shtrembër nga të gjitha forcat politike dhe ushtarake të kohës. Në këtë kontekst të mos harrojmë dhe thënien e akademikut Moikom Zeqo që ka theksuar se “të mos harrojmë se ne shqiptarët e bëjmë historinë, por jo jashtë historisë evropiane dhe botërore. Askush nuk mund të na shfajësojë ose të na justifikojë. Historia ka folur, çështja ka përfunduar!”.

Thënë më shkurt dhe qartë se kjo, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një histori e mbyllur me fitimtarë, duam apo nuk duam. Kjo histori na bërret dhe çirret duke thënë më lexoni dhe më shkruani siç janë dokumentet që fatmirësisht janë të shumta nga “ne”, “ata” dhe “atyre” që na u ndodhën pranë në luftë”. Sipas prof.Zotaj “Përmes këtij libri autori sjell ndihmesën e tij në trajtimin e plotë dhe mbi baza dokumentare

të njëres prej zonave më të veçanta e më të mëdha si Dibra, për kohën kur veptoi, duke sjellë njëherësh dhe një ndihmesë të çmuar në fushën e Historisë Ushtarake Shqiptare. Autori është përpjekur dhe i’a ka arritur të rindërtojë të plotë imazhin e kësaj zone luftarake, me veçoritë e veta daluese si në organizim ashtu edhe në veprimtarinë e dënuar luftarake, pa lënë jashtë trajtës edhe rolin e spikatur të saj, si një burim njerëzor për ngritjen e çetave, batalioneve dhe të brigadës sulmuese.

Në punim, për herë të parë jepet e tërë skema e veçantë organizative, e plotësuar tashmë dhe me të dhënat për drejtuesit kryesor, si dhe me dukuritë e risitë e veprimtarisë luftarake të njësive që vepruan në Dibër. Madje aty sillen në mënyrë të plotë mjaft të dhëna e statistika përmbi formacionet ekzistuese para krijimit dhe të tjerave që u formuan më pas, gjatë veprimtarisë së luftës”.

Analizën e veprës e ka bërë në mënyrë të hollësishme prof.dr.Bernard Zotaj në parathënien e saj, por unë dua të përçoj tek lexuesi mesazhin e domosdoshmërisë së pasurimit të bibliotekës së tij me këtë libër që zë vend të veçantë në fondin e historiografisë sonë të viteve 40-të të shekullit të kaluar. Kjo edhe për faktin se nga mënyra dhe stili i veçantë i të shkruarit, faktet dhe analizat që sjell, “LANÇ në Dibër” është një vepër që pasuron dukshëm fondin e letërsisë sonë dokumentare.

Ela ndjehej shumë e lumtur me dashurinë e saj. Artani ishte djalë i mirë, e donte shumë Elën dhe punonte në një autoservis për të përgatitur sa më të bukur çerdhen e arëdhshme të jetës së tyre familjare.

Ku do të shkosh Ela

HYSEN KICA

Jeta e sinqerte ndoshta është pak më e vështirë por është më e sigurtë

- Ma jep dorën Ela!

Ela takoi dorën e saj me dorën e Artanit, Ndjeu ngrohtësinë e dorës së tij që shtërngonte dorën e saj dhe eci e lumtur pranë tij.

- Ku do të shkojmë Tani?

- Ku të duash ti shpirte, - i tha Artani. - Ndosh-ta mund të shkojmë edhe në Hënë. Mua më mjafton që jemi bashkë.

- Mos ma lësho dorën, - i tha Ela.

- Kurrë. Do ecim kështu gjithmonë bashkë në rrugën e jetës dorpërdorë si dy fëmijë. Unë ti dhe dashuria jonë. Unë të dua shumë Ela.

- Edhe unë të dua shumë Tani.

Ela ndjehej shumë e lumtur me dashurinë e saj. Artani ishte djalë i mirë, e donte shumë Elën dhe punonte në një autoservis për të përgatitur sa më të bukur çerdhen e arëdhshme të jetës së tyre familjare. Kishin rreth gjashtë muaj që ishin njohur dhe ishin dashuruar. Dashuria e tyre, si të gjitha dashuritë, ishte shumë e bukur dhe po bëheshin gati të bisedonin me prindërit e tyre që të caktonin ditën e martesës.

. A shkojmë të marrim diçka Ela!

- Mos i prish lekët çuno se do mbetesh pa martuar.

- Kam fituar tremijë lekë për sot dhe na teprojnë ca për të prishur.

- Sa i mirë je ti Tani im i dashur.

- Ti je më e mirë se unë shpirte. Do bëjmë një dasëm të bukur.

- Unë do të ftoj më shumë se njëqind e pesëdhjetë dasmorë.



Ku është ...DASHURIA...
Nese do dini te lexoni ne rrjeshtat e ketij libri do mund te mesoni jo vetem si fitohet nje dashuri por edhe si mund te gjeni nje bashkpuntor dhe nje bashkudhetar te jetes tuaj.



- Edhe prindërit e mi llogarisin shpesh se sa do ftoj më por akoma nuk kan nxjerrë një shifër të saktë. Mami ngul këmbë që të ftoj më shumë nga njerëzit e saj ndërsa babi mundohet ta binde se nuk duhet të hapemi kaq shumë.

- Po pse nuk e caktoj më ditën e dasmës Tani?

- Mirë e ke zemra ime, - tha Artani. - Të bisedoj më me prindërit dhe ta vendosin ata.

U ulën diku mbi gjelbërimin e pranverës. Artani rrethoi mesin e saj me krahun e tij ndërsa Ela mbështeti kokën te supi i Artanit. Vërtetë kishin marrë vetën një patatinë me erëza por ishin shumë të lumtur. Bota e bukur e dashurisë ishte krejt e tyre.

Ela rastisi një ditë në një supermarket me vël-laun e saj të vogël. Ai pa diku një makinë lodër, e

rrëmbeu dhe kërkonte patjetër që t'ja blinte por asaj nuk i mjaftonin paratë. Ela mundohej ta bindëte se do shkonin në shtëpi e të merrnin paratë e duhura por vëllai nuk e lëshonte lodrën. Kur Ela tentonte t'ja shkëpuste nga duart ai shtrihej në dysheme dhe bërtiste me të madhe aq sa tërhoqi vemendjen e atyre që ndodheshin pranë.

- Pse ja prish qejfin djalit? - i foli një djalë mjaftë i mbajtur që u afrua pranë saj.

- Dua makinën, - tha vëllai i Elës duke e shtërnguar fort..

- Eja se ta blen xhaxhi, - tha djali i panjohur dhe pagoi si një "bos".

Ela u ndje e papërgatitur dhe nuk foli asnjë fjalë ndërsa bosin, që kishte paguar lodrën e vëllaut të saj, dukej shumë i sjellshëm. E mori vëllaun e saj përdore deri sa shkuan te makina e bukur që ndodhej para supermarketit.

- Na falni, - i tha Ela, - por ne do shkojmë në shtëpi.

- Paskeni një vëlla shumë simpatik, - i tha bosin dhe po ju çoj unë.

- Ju falemnderit, - vazhdoi Ela. - Nuk është nevoja.

- Unë do hypi në makinë, - tha vëllai i vogël dhe hyri brenda sapo bosin hapi derën.

Ela u afrua te makina luksoze, kapi vëllain e saj për krahu dhe e tërhoqi jashtë por ai u kap me forcë diku brenda makinës dhe filloi përsëri të bërtiste me sa fuqi kishte.


- Mos bëni kështu, - tha bosin. - U çoj unë ku të doni vetëm mos na bëni gazi i botës. Po na turpëroni në mes të rrugës. Edhe vëllait mos ja prish qejfin se fëmijë është.

Ela u ndje shumë ngushtë. T'ja linte vëllain atij njeriu të panjohur ishte e pamundur prandaj hypi në makinë dhe orientoi shoferin se ku do të shkonin.

Bosin u tregua shumë njeri i mirë, i bëri komplimente Elës, e pyeti për emrin dhe i çoi deri atje ku i kërkoi ajo.

- Ju falemnderit! - i tha Ela kur zbritën.

- Mos e thuaj më ate fjalë, - i tha bosin duke i shtrirë dorën. - Për mua ishte kënaqsi që bëra qejfin një fëmijë.



E NJË GJAKU ME ËNDRRËN

AGRON TUFA

(Vijon nga faqja 6)

A ka ngushëllim? Sigurisht ka. Mbrojtja nga jashtësia armiqësore dhe e pasigurt gjendet midis kozmosit shtëpiak, në udhëtimin imagjinar me Holgersonin dhe patat e tij, duke e nxjerrë huq realitetin përjashta: "Sa niste muzika hyrëse e filmit vizatimor, bëheshim pjesë e udhëtimit të mrekullueshëm të Nils Holgersonit; hynim fill në botën e Nilsit dhe të patave të tij. Nëse te lajmet s'kishim dot asnjë pikë qasjeje, gishtëja i patave të egra vinte miqësisht nga ekrani në shtëpinë dhe ëndërrimet tona. Ç'patë fisnike ishte Akka! Ç'e poshtë dhelpra Smirre, më ngjante me folësen e lajmeve. Ç'folë ëndrrash me misionë ngadhënjyese shtëpia jonë e stokut. Ç'Holgersonë unë e im vëlla që ia përngjasnim Bulqizën universit qiellor të patave të Nilsit".

Ashtu sikurse në veprat letrare, "Krom dhe luledele" është kompozuar me një "epilog" në fund të rrefimit, i cili tërë këtë botë, duket sikur, me kthimin në vendlindje, e mat me sy të picërruar e nostalgji therëse, gjithnjë në rrekje për t'i përfshirë në një kuptim thelbësor të identitetit këto shenja të një bote, që tash, paradoksalisht duket e zvogëluar. Këto parajsja të largëta të fëmijërisë, me harenë dhe trishtimin e tyre na kanë pritur të kthehemi, t'i rizbulojmë e të nisim me ta një tjetër kuvendim, mbase më thelbësorin prej sosh, atë, që i jep peshë dhe vlerë, ngjyrë dhe shije kuptimit të ekzistencës tonë.

Në këtë kyç, rikthimi në tempujt e fëmijërisë (teqeja e Dervish Çaushit) dhe gjetja, midis sendeve mbi varrin e shenjtëve të një ditari anonim, merr vlerën e një shenjuesi eksplicit, përtej përvojës sonë, e njëherësh, universalizimin, kërkimin e etur përtej përvojave tona të brendshme, në një zonë ku duhet të gjendet "tjetri i ngjashë", binjakësia jonë,



ndoshta kipci ynë, ndoshta alter ego-ja jonë e një gjaku me ëndrrën.

* * *

Sikur autorja ta kishte bërë rrëfimin e prozës "Krom dhe luledele" nga veta e tretë njëjës, duke e mënjeluar vetën e parë rrëfyese, do të zhdukeshin të gjitha simptomat dalluese të një veprë letrare memuaristike dhe ne, sipas përkufizimeve klasike, do t'i vinim një emërtim të saktë zhanrit të kësaj

prozë, duke e quajtur atë roman. Po përderisa, sikundër u munduam ta dëshmojmë më sipër, për nga gjuha, maniera e të shkruarit, penelatat lirike, kompozimi dhe semantika, vepra i ka të gjithë këto thelbe letrare, atëherë pse të mos quhet roman? Kush na pengon?

Mendoj se kemi të bëjmë me tipin e romanit autobiografik, njësoj, fjala vjen si romani autobiografik "Fëmijëria" i Lev Tolstoit.

Ku do të shkosh Ela

(Vijon nga faqja 10)

Ela u largua pa e kthyer kokën pas dhe e grushtoi vëllain e saj sapo arritën në shtëpi por loja nuk mbaroi këtu. Djali i panjohur, ose "bosi" sikur i shfaqej rastësisht përpara, e përshëndeste Elën dhe një ditë e ftoi "për kafe". Mendoj se edhe ajo duhet të ishte e sjelleshme ndaj këtij djali të kulturuar dhe pranoi.

Kur erdhi rradha të paguante bosin nxorri nga xhepi një tufë të madhe me para dhe ndau prej tyre një pesmijlekshe për t'ja dhënë kamarierit.

Një botë, krejt tjetër nga bota ku jetonte Ela, u hap para saj. Pa e kuptuar ajo filloi ta pëlqente këtë botë dhe ta ëndërronte. Filloi të shmangej Artanit. Filloi edhe ta harronte dhe ta zëvendësonte me bosin. Djali i ri, që po futej në botën e saj, kishte para pa masë, e dërgonte në lokale moderne dhe i blinte çfarë të pëlqente ajo. Kujtoi se fati i zbriti nga qielli dhe rendi si e çmendur në botën e re.

- Ela, Ela! Ela shpirte. Pse nuk po vijmë prindërit tu e të bisedojmë më prindërit e mij të caktojme ditën e dasmës? - e pyeti Artani.

- Më vjen keq Artan por mendoj se nuk duhet të ngutemi.

Artanit i bëri shumë përshtypje që Ela e tij e dashur nuk i tha më "Tani im i dashur" dhe ndjeu se një thikë mizore donte të ngulej në zemër.

- Mos thuaj ashtu shpirte. Këtë verë ne duhet të martohemi patjetër.

- Nuk e di, - tha Ela. - Martesa është një vendim shumë serioz dhe mua më duhet të mendohem mirë para se të vendos.

Artani e kuptoi se Ela po ndryshonte, iu lut disa herë që të mos e shkatërronte dashurinë e tyre të bukur, u ul në gjunjë para saj por... Mjerë kush ulet në gjunjë dhe lutet një njeriu që nuk e dashuron.

- Pse më flet kështu shpirti im?

Ela tani kishte kaluar në një botë krejt tjetër. Filloi të frekuentonte lokalet më të shtrenjta, të pinte pije alkolike, të pinte cigare, të vishej tepër moderne dhe të shoqërohej me një qen. Artani nuk egzistonte më në botën e saj dhe ato quravitjet e tij e pështiroshin. Tani ajo i shikonte njerëzit si milingona dhe të shkilte me këmbë. Bosi kishte hapur para saj një botë të re dhe kishte para me të thyer kokën. Ai nuk maste kurër sa prishte për ti bërë qejfin Elës. Asaj po i vinte keq që nuk e kishte njohur me kohë bosin dhe që kishte dashuruar ate pabuksin që e kishte emrin Artan.

Por... Një ditë Bosi kishte dërguar dy shokë atje ku e prishte gjithmonë. Ata i thanë se bosin nuk ishte mirë dhe kishte dërguar ata që ta merrnin. U merakos për shëndetin e bosit dhe shkoi me shokët e tij. Për çudi bosin nuk ishte aty ku e

dërguan ata.

- Ku është bosin? - pyeti Ela e merakosur se mos ishte sëmurë.

- Bosin ka shkuar në Angli, - i tha njeriu prej tyre.

- Si ka mundësi! - foli Ela e habitur. - Pse nuk më paska thënë mua?

- Mos u mërzi bukuroshe, - i foli njeriu prej tyre. - Bosin na ka porositur ne që të kujdesemi për ty. Do ta bëjmë qejfin më tepër se bosin sepse ne jemi dy dhe do ta bëjmë me rradhë ose edhe të dy njëherësh. Si të pëlqej ty më shumë.

E mbajtën Elën për dy ditë të mbyllur brenda duke e zhfrytëzuar me të gjitha mënyrat dhe pastaj e braktisën në rrugën e harresës. Lumturia e pafundme e kishte dërguar buzë një gremine të pafundme.

Ela! Ajo kishte rendur si e marrosur në një rrugë mashtruese të mbuluar me para dhe jo me dashuri. Tani kishte arritur në fundin e kësaj rruge dhe fundi ishte i tmerrshëm.

Ecte kot nepër errësirën e thelle të natës pa asnjë dëshirë për të jetuar. E vetmuar, e braktisur dhe e shkatërruar në gjithë qenien e saj njerëzore. Gjithë bota e saj shpirtërore pothuajse kishte vdekur në pak ditë. Drita e cigares së ndezur griste terrin që e rrethonte ndërsa qeni i kishte mbetur i vetmi mik në botë. Ku vallë mund të shkonte tani!

Dokumentari qe mjaftë mbresëlënës për faktin se artistë të njohur evidentonin vlerat e Skënder Calës si këngëtar, regjisor e aktor, ndërsa në mbyllje jepen çaste nga dekorimi i tij me titullin "Mjeshtër i Madh"...




HALIL RAMA

promovon librin e 15-të "Në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare"

Në sallën e madhe të Muzeut Kombëtar ku u promovua libri "Skënder Cala - 'Mjeshtër i madh', në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare", qindra personalitete të artit, kulturës e letrave ndoqën me interes e vëmendje edhe dokumentarin me të njëjtin titull të autorit Halil Rama.

Dokumentari qe mjaftë mbresëlënës për faktin se artistë të njohur evidentonin vlerat e Skënder Calës si këngëtar, regjisor e aktor, ndërsa në mbyllje jepen çaste nga dekorimi i tij me titullin "Mjeshtër i Madh", ku Presidenti i Republikës Bujar Nishani, pasi vlerëson aftësitë artistike dhe ato njerëzore të këtij artistit që janë shijuar edhe vlerësuar si brenda edhe jashtë vendit shprehet se: "Vlerat e Skënder Calës shkojnë përtej kontributit të artit shqiptar.

Ai mbi të gjitha kontribuoj në zbulimin e artistëve të rinj, i cili i përgatiti duke ju dhënë shumë nga vetja e tij, në mënyrë që ato të ishin të përgatitur për të konkuruar në skenën e artit shqiptar por edhe më gjerë. Dhe sot ata, duke ecur në hapat e mjeshtrit të tyre, profesorit të tyre kanë një emër në jetën artistike si brenda ashtu edhe jashtë vendit".



RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme

Një program i rezervuar dhe personalizuar për qytetarët shqiptarë për të hyrë në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatorial i përbërë nga 11 qendra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundsohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përballueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,
- resonance magnetike, tac - Mamografi dhe tomosintezë, - ekografi ...

me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit). **ORGANIZOJME GJITHÇKA** në kohën që ju ose i afërimi juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizite e pacientit me përkthyes shqipëtar.

**Per informacione dhe prenotime na \kontaktoni: Email: age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580
WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)**

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose i afërimi juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

**Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp
00392380019580
Age Biba (Dukagjini)**